

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
për vitin II
Arsimi i gjimnazit

Shkup, 2025

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Gjuhë shqipe dhe letërsi</i>
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Viti	II (i dytë)
Temat/fushat e programit mësimor	• Gjuhë dhe komunikim • Letërsi, të shprehurit dhe krijimtaria • Njohuri mediatike
Numri i orëve mësimore	4 orë në javë / 144 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	• Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, tabelë shkollore, teknologji kompjuterike, printer. • Mjetet dhe burimet mësimore: fotografi, afishe me fotografi, piktura të figurave letrare, diagrame dhe ilustrime për materialin mësimor, tabela që përcjellin materialin sipas fushave programore; fjalorë, fjalorë drejtshkrimor, leksikonë, enciklopedi, libra, programe kompjuterike edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale; • Biblioteka e klasës, biblioteka e shkollës.
Normativi për kuadrin mësimor	Mësimdhënjen e lëndë së gjuhës shqipe dhe letërsisë në vitin II të arsimit të gjimnazit mund ta realizojë personi që ka kryer drejtimin arsimor të programit studimor: • Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi.

REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: GJUHË DHE KOMUNIKIM

Gjithsej: 65 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të shpjegojë dhe të krahasojë faktet historike dhe rrethanat shoqërore në kontekstin e çështjes gjuhësore në shekullin XIX dhe rëndësinë e intelektualëve shqiptarë dhe të shkrimtarëve të teksteve shkollore dhe të veprave të tyre në zhvillimin e gjuhës shqipe;
2. të njohë, të krahasojë dhe të interpretojë pikëpamjet e veprimtarëve shqiptarë mbi krijimin e gjuhës së njësuar, mbi tiparet e përbashkëta të pikëpamjeve të ndryshme dhe mbi rëndësinë e gjuhës shqipe në këndvështrimin e gjuhës së njësuar.
3. të kuptojë dhe të zbatojë drejt sinonimet, antonimet dhe homonimet dhe të dallojë arkaizmat, historizmat, krahinarizmat, neologjizmat, profesionalizmat, njësitë frazeologjike në tekstet e dhëna.
4. të njohë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (emri, mbiemri, përemri, numërori, folja) dhe të zbatojë kategoritë e tyre gramatikore gjatë përdorimit të fjalëve dhe fjalive në komunikimin me shkrim dhe me gojë.
5. të njohë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës (ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza, pasthirrma), të shpjegojë kuptimin dhe rolin e tyre në fjali dhe t'i zbatojë ato drejt në të folur dhe në të shprehurit me shkrim për të arritur qartësi, koherencë dhe shprehshmëri.

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

1. gjuha si sistem i gjallë ndryshon në përputhje me nevojat shoqërore;
2. është i/e vetëdijshëm/-me për rëndësinë e përdorimit të drejtë të gjuhës si mjet i komunikimit të suksesshëm;
3. ka interes dhe vlerësim për veprat letrare si mjet i zhvillimit të të menduarit kritik dhe të empatisë.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

Standardet e vlerësimit:

RRETH GJUHËS SHQIPE

Zhvillimi historik i gjuhës Shqipe

Gjuha shqipe në shekullin XIX

(Rilindja Kombëtare dhe përpjekjet për njësimin e alfabetit dhe të gjuhës shqipe, alfabetet, abetaret, gramatikat, fjalorët, shoqëritë dhe klubet kulturore, shkollat dhe arsimi në gjuhën amtare shqipe, baza dialektore e gjuhës standarde shqipe, leksiku fetar, leksiku i huaj

- Shpjegon pse shekulli XIX ishte i rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës shqipe, vetëdijesimin për nevojën e njësimin të alfabetit dhe të gjuhës dhe lidh idenë e gjuhës shqipe me identitetin kombëtar.
- Numëron dhe njeh përfaqësuesit më të rëndësishëm të Rilindjes Kombëtare (“*Ëvetari*” i Naum Veqilharxhit, Kongresi i Alfabetit, gramatikat e para – Dhimitër Kamarda, Kostandin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Mësonjëtorja shqipe e Korçës, “*Fjalori i gjuhës shqipe*” i Kostandin Kristoforidhit, “*Shoqëria e të shtypurit*”

	<i>shkronja shqip</i>) dhe vlerëson kontributin e tyre për zhvillimin e gjuhës dhe për ngritjen kulturore të kombit shqiptar. • Analizon tiparet gjuhësore në veprat e rilindësve shqiptarë, duke dalluar elementë të leksikut fetar dhe atij të huaj. • Analizon motivet, idetë dhe misionin kulturor të rilindësve shqiptarë në kontekstin e krijimit të vetëdijes kombëtare.
GRAMATIKA	
Leksikologjia Leksikologjia si degë e gjuhësisë (koncepti për fjalën (përmbajtje/formë), leksikologjia, leksiku, leksema, kuptimi leksikor dhe gramatikor, fjalët me një kuptim dhe fjalët me shumëkuptimësi; sinonime, homonime, antonime, paronime; arkaizma, historizma, neologjizma; fjalë burimore dhe fjalë të huaja; sllavizma, ndërkombëtarizma, orientalizma dhe barbarizma; leksiku bisedor, leksiku letrar (letraro-artistik), ekspresive, leksik i përgjithshëm popullor dhe dialektor, profesionalizma, leksik zhargonik dhe terminologjik, fjalor aktiv dhe pasiv; njësitë frazeologjike) Fjalorët dhe llojet e tyre (shpjegues, etimologjik, enciklopedik, frazeologjik, fjalor dygjuhësh, shumëgjuhësh, drejtshkrimor etj.)	• Njih dhe i shpjegon konceptet bazë dhe llojet e kuptimit leksikor (fjalët me një kuptim, fjalët me shumëkuptimësi, sinonimet, antonimet, homonimet, paronimet). • Analizon fjalët sipas prejardhjes (arkaizma, historizma, neologjizma; fjalë burimore dhe fjalë të huaja; sllavizma, ndërkombëtarizma, orientalizma dhe barbarizma), sipas kuptimit dhe sipas përdorimit stilistik në tekst. • Dallon kuptimin leksikor nga ai gramatikor dhe i zbaton gjatë analizës së fjalëve dhe fjalive. • Përdor shtresën stilistike përkatëse dhe leksikun terminologjik gjatë krijimit të tekstit që krijon vetë. • Vlerëson aspektin stilistik dhe shprehës të llojeve të ndryshme të leksikut (bisedor, letrar, ekspresiv, terminologjik) në një tekst të dhënë. • Dallon njësitë frazeologjike dhe kuptimet e figurshme të tyre. • Dallon llojet e ndryshme të fjalorëve dhe i përdor ato për qëllime mësimore.
Morfologjia dhe morfosintaksa Morfologjia si degë e gjuhësisë (fjala dhe pjesët e saj përbërëse; morfema, llojet e morfemave: fjalëformuese (parashtesa, rrënja dhe prapashtesa) dhe trajtëformuese (mbaresa dhe prapashtesa trajtëformuese), tema e fjalës)	• Shpjegon ndryshimin midis një morfeme rrënjore dhe një morfeme ndajshësore. • Shpjegon se si morfemat fjalëformuese krijojnë fjalë të reja. • Shpjegon funksionin e morfemave trajtëformuese në ndryshimin e trajtës së fjalës. • Dallon morfemën fjalëformuese nga morfema trajtëformuese. • Analizon dallimet midis fjalëve të prejardhura, kompozitive dhe konversionit përmes shembujve konkretë. • Shpjegon dallimet midis pjesëve të ligjëratës sipas funksioneve të tyre gramatikore.

Fjalëformimi (fjalë të parme, fjalë të prejardhura, fjalë të përbëra (kompozita, fjalë të përngjitura); nyjëzimi, konversioni) Pjesët e ligjëratës Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës Emri (llojet e emrit (të përgjithshëm, të përveçëm, konkretë, abstraktë, të lëndës, përmbledhës); kategoritë gramatikore të emrit (gjinia, numri, trajta, rasa); lakimi i emrit; funksionet e emrit në fjali) Mbiemri (llojet e mbiemrit (sipas ndërtimit – të nyjshëm, të panyjshëm dhe sipas kuptimit – cilësorë, marrëdhëniorë); kategoritë gramatikore të mbiemrit; formimi i gjinisë femërore te mbiemrat, formimi i shumësit te mbiemrat; kategoria e shkallës te mbiemrat cilësorë; funksionet e mbiemrit në fjali) Përemri (llojet e përemrave: vetorë (trajtat e shkurtra dhe bashkimi i trajtave të shkurtra), dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë, të pacaktuar; kategoritë gramatikore të përemrave; funksioni i përemrave në fjali) Folja	• Identifikon kategoritë gramatikore të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës dhe shpjegon rolin e tyre në një fjali. • Përdor gjininë, numrin, trajtën dhe rasën e duhur të emrave në fjalitë dhe tekstet që i krijojnë vetë. • Zbaton emrat në funksione të ndryshme sintaksore (kryefjalë, përcaktor, kundrinor, rrethanor, pjesë emërore të kallëzuesi emëror) brenda një fjalie. • Zbaton rregullat për përshtatjen e mbiemrit me emrin në gjini, numër, trajtë dhe rasë në fjali dhe në tekste. • Përdor shkallët e mbiemrave cilësorë në të shprehurit me shkrim dhe me gojë. • Përdor lloje të ndryshme mbiemrash (cilësorë, marrëdhëniorë) gjatë krijimit të fjalive dhe të teksteve të shkurtra. • Zbaton njohuritë për mbiemrat gjatë pasurimit stilistik të tekstit (duke zgjedhur mbiemër të përshtatshëm sipas kontekstit). • Zbaton në mënyrë të drejtë llojet e ndryshme të përemrave në fjali dhe në tekste të shkurtra. • Dallon dhe përdor drejt trajtat e shkurtra të përemrave vetorë. • Përdor përemrat dëftorë për të shprehur qartë afërsinë ose distancën në komunikimin me gojë dhe me shkrim. • Dallon kategorinë gramatikore të vetës, gjinisë numrit dhe rasës të përmrave pronorë. • Njeh kategoritë themelore gramatikore të foljes në një fjali: mënyrën, kohën, vetën, diatezën, numrin; foljen kalimtare dhe jokalimtare. • Përdor trajtat e kategorive gramatikore të foljeve në komunikimin me gojë dhe me shkrim. • Përdor kohët e thjeshta (të tashmen, të pakryerën, të kryerën e thjeshtë, të ardhmen) dhe kohët e përbëra (të kryerën, më se të kryerën, të kryerën e tejshkuar, të ardhmen e përparme) kur harton tekst ose në dialog. • Dallon, krahason dhe zbaton te foljet kategorinë gramatikore të mënyrës (dëftore, lidhore, habitore, urdhërore, dëshirore, kushtore) në fjali dhe në kontekste të ndryshme komunikimi.
---	---

(Kategoritë gramatikore të foljes (mënyra, koha, veta, diateza, numri); zgjedhimi i foljeve; folje pavetore; forma veprorë dhe joveprorë; folje kalimtare dhe jokolimtare; kohët e thjeshta (e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë, e ardhmja) dhe kohët e përbëra (e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar, e ardhmja e përparme), mënyra dëftore, lidhore, habitore, urdhërore, dëshirore, kushtore (kuptimi dhe përdorimi); format e pashtjelluara; foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse (modale); funksioni i foljes në fjali) Numërori (numërorët themelorë, numërorët rreshtorë; funksioni i numërorëve në fjali) Pjesët e pandryshueshme të ligjeratës Ndajfolja (llojet e ndajfoljeve (të mënyrës, të vendit, të kohës, të shkakut, të sasisë); kategoria e shkallës të disa ndajfolje; fjalëformimi dhe funksioni i ndajfoljeve në fjali) Parafjala (parafjalët sipas strukturës morfologjike, parafjalët sipas rasave) Lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore (bashkërenditëse; nënrenditëse; shprehjet lidhëzore) Pjesëza (pjesëza me ngjyrimë kuptimore të ndryshme (dëftuese, përcaktuese-saktësuese, përafruese), pjesëza modale	• Përdor format e pashtjelluara të foljes (pjesoren, paskajoren, percjelloren) në fjali dhe në tekste të shkurtra. • Krijon fjali ose tekste të shkurtra duke përdorur ndërtime me foljet ndihmëse <i>kam e jam</i> dhe foljet gjysmëndihmëse (<i>mund, duhet</i> etj.), duke i përshtatur ato sipas kontekstit. • Analizon funksionin e foljeve në fjali. • Dallon numërorët themelorë nga numërorët rreshtorë dhe i përdor drejt ato në të shprehurit me gojë dhe me shkrim. • Përdor lloje të ndryshme ndajfoljesh (të mënyrës, të vendit, të kohës, të shkakut, të sasisë) kur krijon fjali dhe tekste të shkurtra. • Përdor ndajfoljen e duhur për të plotësuar foljen, mbiemrin ose ndajfoljen tjetër në një fjali. • Përdor kategorinë e shkallës të ndajfoljet aty ku është e mundur (<i>shpejt – më shpejt – shumë shpejt</i>) në të shprehurit me gojë dhe me shkrim. • Përdor ndajfoljet në funksione të ndryshme në një fjali – si përcaktorë, rrethorë të mënyrës, të vendit, të kohës, të shkakut, të sasisë. • Zbaton parafjalë të parme, të përngjitura dhe shprehje sipas rasave përkatëse në komunikimin me gojë dhe me shkrim për të shprehur drejt marrëdhëniet midis fjalëve. • Përdor parafjalët përkatëse në mënyrën e duhur duke i vendosur para emrave, përemrave dhe numërorëve në varësi të kontekstit. • Përdor lidhëzat për të shprehur marrëdhënie logjike midis pjesëve të një fjalie të përbërë (kundërshtim, marrëdhënie shkak-pasojë, qëllim, kohë, kusht etj.) • Përdor shprehje lidhëzore për të lidhur logjikisht pjesë të një teksti. • Përdor njohuritë mbi lidhëzat për të krijuar tekst koherent dhe të lidhur (kur rrëfen, shpjegon ose argumenton). • Përdor pjesëzat me ngjyrimë kuptimore të ndryshme (<i>ja, mu, bile</i> etj.); (<i>po, jo, po se po, nuk, a</i> etj.) pjesëza emocionuese-shprehëse (<i>de, pra, pale</i> etj.) në fjali dhe tekste të shkurtra dhe në dialog. • Zbaton pasthirrat për të shprehur reagime emocionale, për të nxitur dhe për të përshëndetur.
--	---

(pohuese, mohuese, pyetëse, dyshuese, zbutëse), pjesëza emocionuese-shprehëse) Pasthirrma (pasthirrma emocionuese (shprehin gëzim, kënaqësi, entuziazëm, admirim, habi, tmerr, hidhërim); pasthirrma nxitëse; pasthirrma përshëndetje)	Përdor shprehjen e intonacionit dhe shenjat e pikësimit që shoqërojnë prezencën e pasthirmave në një fjali.
Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi Shenjat e pikësimit	- Zbaton rregullat e drejtshkrimit dhe pikësimit gjatë shkrimit të fjalive dhe teksteve. - Përdor shenjat e pikësimit për të shprehur qartë mendimin në lloje të ndryshme tekstesh. - Përshtat përdorimin e shenjave të pikësimit sipas qëllimit komunikues dhe sipas stilit të të shprehurit.
TË DËGJUARIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT	
Të dëgjuarit dhe të shkruarit për të kuptuar (lajm, intervistë, podcast, fjalim, tekste gazetareske, informative, artistike, reklamuese, eseistike) Të shkruarit dhe të shprehurit Të shprehurit me gojë dhe komunikimi kritik	- Njih temën, qëllimin dhe informacionet kyçe në burime të ndryshme audio dhe të shkruara (lajm, intervistë, podcast, tekst, fjalim). - Veçon të dhënat relevante dhe i lidh ato me njohuritë e mëparshme. - Kupton përmbajtjen, qëllimin dhe strukturën e llojeve të ndryshme të teksteve (gazetareske, informative, artistike, reklamuese, eseistike). - Identifikon fakte, qëndrime dhe elemente emocionale dhe i analizon ato në kontekst. - Krahason burimet sipas saktësisë, besueshmërisë dhe pikëpamjeve. - Shpreh mendimin personal në mënyrë të qartë, logjike dhe të argumentuar. - Krijon lloje të ndryshme teksti (ese, letër, recension, koment, raport) në përputhje me qëllimin komunikues dhe me strukturën. - Zbaton rregullat e drejtshkrimit, gramatikës dhe shprehjes stilistike gjatë krijimit të teksteve. - Përdor informacion burimor duke respektuar autorësinë (parafrazim, citim dhe referim i burimeve). - Kombinon të dhënat nga burime të ndryshme për të krijuar një tekst të ri, personal me qëndrim origjinal. - Përdor koherencë gjuhësore dhe logjike për lidhjen e ideve dhe pjesëve të tekstit.

	• Shpreh qartë dhe në mënyrë të argumentuar qëndrimet gjatë diskutimeve, debatit ose prezantimit me gojë. • Përdor mjetet gjuhësore përkatëse sipas kontekstit, audiencës dhe qëllimit të komunikimit.
Shembuj veprimtarish: Veprimtari dhe ushtrime praktike • Krijimi i tekstit me lidhëza: Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër (5–6 fjali), në të cilin përdorin lidhëza bashkërenditëse dhe lidhëza nënrenditëse. • Nxënësit shkruajnë një koment/mendim të shkurtër për tekstin, duke përdorur pasthirrma për të shprehur emocione dhe nxitje dhe për të përshëndetur. • Sinteza e ideve: Nxënësit kombinojnë të dhëna nga dy tekste të ndryshme dhe përgatitin një raport ose ese të shkurtër. Veprimtari hulumtuese: • Eksperimente gjuhësore: Nxënësit studiojnë se si fjalët shumëkuptimshme ndryshojnë kuptimin e tyre gjatë përdorimit në kontekste të ndryshme dhe prezantojnë shembuj në orën mësimore. • Hulumtim i stileve: Nxënësit krahasojnë tekste të shkurtra nga autorë të ndryshëm dhe analizojnë se si përdorimi i përemrave, i parafjalëve dhe i pasthirmave ndikojnë në stilin dhe në shprehshmërinë e tekstit. • Funksionet e përemrave: Nxënësit zgjedhin një tekst dhe analizojnë përdorimin e përemrave vetorë, dëftorë dhe lidhorë, duke caktuar funksionin e tyre në fjali. Kuize dhe gara • Gjueti gjuhësore e fjalëve: Nxënësve në grupe u jepet një tekst. Për detyrë kanë që brenda një kohe të caktuar, të gjejnë sa më shumë shembuj të emrave, të mbiemrave, të ndajfoljeve ose të numërorëve. • Bingo sintaksore: Jepet një tabelë me funksione të ndryshme të fjalëve në fjali nga një tekst i dhënë (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, rrethanor). Nxënësit pranë secilit funksion i shkruajnë fjalët e tekstit që në fjali kryejnë funksionin përkatës (p.sh. Teksti: <i>Fëmijët e lagjes</i>	

luajnë rregullisht në oborrin e shkollës. Ata i respektojnë rregullat e orarit të punës së shkollës...). Pasi i vendosin fjalët pranë funksionit përkatës, tregojnë se cilës pjesë të ligjëratës i takojnë, p.sh:

Kryefjalë	<i>Fëmijët, Ata</i>
Kallëzues	<i>Luajnë, respektojnë</i>
Përcaktor	<i>E lagjes, e shkollës, e orarit, të punës, së shkollës</i>
Rrethanor	<i>Rregullisht, në oborrin</i>

Fëmijët – emër; *Ata* – përmër vetor; *Luajnë* – folje; *Respektojnë* – folje; *E lagjes*– emër , *E shkollës*– emër, *E orarit*– emër, *Të punës*– emër, *Së shkollës*– emër; *Rregullisht* – ndajfolje; *Oborrin* – emër.

- **Përqendrim i shpejtë:** Nxënësit u përgjigjen shpejt pyetjeve lidhur me informacionet kryesore, qëndrimet dhe faktet nga një tekst ose nga një material audio.
- **Rrethi i debatit:** Nxënësit ndahen në dy grupe. Secili grup duhet të argumentojë qëndrimin e tij bazuar në një tekst/audio, duke i përdorur format e pashtelluara të foljes.
- **Koherencë logjike:** Nxënësit marrin fragmente nga një tekst pa ndonjë lidhshmëri midis fjalive. Detyra e tyre është të rindërtojnë tekstin me rrjedhë logjike dhe koherente.

Fusha programore: **LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA**

Gjithsej: 65 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë :

1. të dëgjojë dhe të lexojë me kuptim tekste letrare nga periudha të ndryshme letrare (baroku, klasicizmi, romantizmi);
2. të analizojë tekste letrare duke përdorur koncepte letrare-teorike nga narratologjia dhe poetika karakteristike e periudhave letrare dhe përfaqësuesve të tyre;
3. të shpjegojë dhe të dallojë karakteristikat e veprave letrare përmes shembujve nga letërsia shqiptare dhe botërore, duke përfshirë letërsinë popullore shqipe dhe mbledhësit folklorit;
4. të formulojë pikëpamje argumentuese dhe kritike mbi veprat letrare dhe fenomenet kulturore dhe shoqërore, duke i lidhur ato me kontekstet bashkëkohore;
5. të krijojë tekste origjinale - lloje të ndryshme esesh dhe tekstesh krijuese në vargje dhe prozë, duke respektuar normat gjuhësore, strukturën dhe rregullat për t'u shprehur me shkrim.

<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i> - të lexuarit me të kuptuar i veprave letrare ndikon në zhvillimin e aftësive të komunikimit, mënyrën e të menduarit dhe zhvillimin e kreativitetit; - aftësitë e fituara përmes leximit dhe interpretimit të teksteve letrare janë të zbatueshme dhe të dobishme për të nxënë dhe për të përvetësuar njohuri në të gjitha fushat e tjera.	
Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):	Standardet e vlerësimit:
Periodizimi i letërsisë (nga gjysma e dytë e shekullit XVI deri në mesin e shekullit XIX: barok, klasicizëm, iluminizëm dhe romantizëm) Baroku (1570-1570) (baroku në letërsi, arkitekturë dhe arte të bukura; karakteristikat: ekzagjerim, ornamente, misticizëm; manierizëm; motive: të pazakonta, misterioze, të fshehta; mjete stilistike: metaforë, hiperbolë, antitezë; <i>carmina figurata</i> (vargje në formë); vepra letrare: lirike dhe dramatike; përfaqësues (autorë nga Spanja dhe Italia)	- Përcakton termin lëvizje letrare. - Identifikon lëvizje të ndryshme letrare, rendit shtrirjen e tyre kohore dhe kushtet socio-historike të shfaqjes. - Shpjegon lidhjen midis lëvizjeve letrare dhe arteve të tjera (pikturë, muzikë, arkitekturë, filozofi). - Përcakton shtrirjen kohore dhe i përshkruan ato në rrethanat kulturore dhe historike të shfaqjes së barokut. - Numëron dhe përshkruan karakteristikat kryesore të letërsisë baroke. - Identifikon motive, tema dhe mjete stilistike karakteristike të barokut. - Numëron përfaqësues dhe vepra të letërsisë baroke në kontekst evropian dhe botëror. - Njih dhe analizon <i>carmina figurata</i> (vargje në formë) dhe i krahason ato me shembuj bashkëkohorë. Vepra për analizë/përzgjedhje/fragmente: - <i>Fragmente nga vepra të zgjedhura</i> nga Pedro Calderon de la Barca, Lope de Vega, Luis de Gongora, Xhanbatista Marino, Torquato Tasso. - Një poezi e zgjedhur nga përmbledhja poetike "<i>Lum Lumi</i>" nga Ali Podrimja (krahasim me <i>carmina figurata</i> - poezi ku renditja vizuale e vargjeve shfaqet qartë si një formë grafike, p.sh. si shkallë, si shtylla, si rreth etj.)
Klasicizmi (nga shekulli XVII deri në fillim të shekullit XIX) (klasicizmi-neoklasicizmi-pseudoklasicizmi, ide dhe	- Shpjegon termin klasicizëm dhe përshkruan kohën dhe kushtet shoqërore të shfaqjes së tij. - Identifikon dhe interpreton idetë themelore dhe parimet estetike të klasicizmit. - Përshkruan rregullat dhe normat për krijimin e veprave letrare në përputhje me poetikën e klasicizmit.

parime themelore të klasicizmit: reputacioni i letërsisë antike; ekuilibri midis frymëzimit dhe arsyes; uniteti i arsyes, bukurisë dhe moralit; arritja e përsosmërisë; Normat dhe rregullat në letërsi - kulti i rregullave; (teoria e tre njësive të dramës: koha, hapësira, aksioni; klasifikimi i zhanreve letrare: oda e lartë, himni, epik; zhanre të mesme - elegji, satirë, fabulë, epigram; zhanre të ulëta - komedi; tipare stilistike: shprehje e qartë dhe e pastër, stil madhështor, përsosmëri dhe harmoni në kompozim; përfaqësues (autorë nga Franca, Anglia, Gjermania)	• Klasifikon zhanret letrare në klasicizëm. • Numëron përfaqësuesit dhe veprat më domethënëse të klasicizmit në kontekstin evropian. • Njih dhe analizon idetë në veprat e klasicizmit. • Krahason llojet dhe motivet dramatike në veprat e klasicizmit me tekstet dramatike bashkëkohore. Vepra për analizë/përzgjedhje/fragmente: - <i>Fragment "Arti poetik"</i> nga Nikolla Boallo - <i>"Sidi"</i> nga Pjer Kornej - <i>"Tartufi"</i> nga Zhan-Batist Poklen Molier - <i>"Fabula"</i> nga Zhan La Fonten - Krahasim me tekstin dramatik bashkëkohor: <i>"Parajsa e çmendur"</i> nga Jeton Neziraj me veprën <i>"Tartufi"</i> nga Molieri (hipokrizia, manipulimi, viktimizimi, satira, mesazhi etj.)
Iluminizmi (shekujt XVII-XVIII) (Iluminizmi, racionalizmi, progresi, arsimi, shkenca, <i>tabula rasa</i>, besimi në njeriun dhe të drejtat e tij natyrore, arsimi, toleranca midis feve; Temat për krijim: edukimi, ndikimi i mjedisit, liria njerëzore, lufta kundër pabarazisë; Qëllimi i letërsisë: iluminizmi i popullit; llojet e veprave letrare: romani, drama, traktate, shkrime mësimore, fabula; përfaqësues (autorë nga Anglia, Gjermania, Franca, Rusia)	• Shpjegon kornizën kohore-kulturore të iluminizmit dhe kushtet shoqërore të shfaqjes së tij. • Shpjegon thelbin e iluminizmit si një lëvizje intelektuale dhe shpirtërore e bazuar në racionalizëm dhe besimin në përparimin njerëzor nëpërmjet arsyes.. • Përshkruan dhe interpreton idetë themelore të iluminizmit: besimin te njeriu dhe të drejtat e tij natyrore, rëndësinë e arsimit dhe tolerancën midis feve. • Numëron përfaqësuesit më të rëndësishëm evropianë të iluminizmit. • Njih dhe analizon idetë dhe motivet iluministe në veprat e asaj periudhe. Vepra për analizë/përzgjedhje/fragmente: - <i>"Kandida"</i> nga Volteri - Përzgjedhje fabulash nga Dositej Obradović - Përzgjedhje fabulash nga I. A. Krilov dhe krahasim me <i>"Fabula dhe tregime për fëmijë"</i> nga Naum Prifti

Iluminizmi në letërsinë shqiptare (shekulli XVIII dhe XIX) (Iluminizmi, karakteristikat e Iluminizmit, gjuha e folur, karakteri udhëzues i veprave, fillimi i krijimit të një gjuhe letrare shqipe, tiparet gjuhësore të teksteve - letra, poema, përpjekje, përfaqësues të iluminizmit, Voskopoja, shtypshkronjat e para.	• Shpjegon thelbin dhe shfaqjen e ideve iluministe në letërsinë shqiptare , duke i lidhur ato me kontekstin europian të Iluminizmit. • Njeh iluministët më të rëndësishëm shqiptar – Theodor Kavaliotin, Dhanil Haxhiun, Dhaskal Todrin si përfaqësues të shek. XVII dhe Naum Veqilharxhin, Kostandin Kristoforidhin, Papa Kristo Negovani, Petro Nini Luarasi si përfaqësues të shek. XIX dhe lidh veprat e tyre me mendimin iluminist. • Shpjegon llojin dhe funksionin e teksteve iluministe dhe rolin e tyre edukativ dhe shoqëror në kohën e krijimit. • Shpjegon rolin që luajti “<i>Akademia e re</i>” dhe Voskopoja si qendër e rëndësishme kulturore e arsimore në emancipimin e përgjithshëm kombëtar. • Komenton fragmente nga veprat e iluministëve shqiptar, duke shpjeguar rëndësinë e tyre historike, gjuhësore dhe kulturore. • Njeh rolin dhe rëndësinë e shtypshkronjave të para (Shoqëria e Stambollit, Shoqëria e Bukureshtit, Shoqëria e Arbëreshëve të Italisë etj.) në përhapjen e ideve dhe letërsisë iluministe.
Romantizmi (shekulli XIX) (romantizmi - një reagim kundër klasicizmit dhe rregullave të tij të rrepta; parimet e romantizmit: emocionet, fantazia dhe shprehja individuale në plan të parë; ëndrra, frymëzimi, personaliteti i poetit dhe bota e brendshme e njeriut, subjektiviteti; tiparet e krijimit: forma e lirë dhe individualiteti artistik; përzierja e zhanreve letrare; format kryesore letrare: roman me tipare romantike, kompozimi i një romani; roman epistolar, roman në vargje; poema, tiparet e poemës, elementët romantikë në poemë (mall, trishtim, motiv udhëtimi dhe zbulimi i vendeve të panjohura); muzikaliteti (vargëzim-varg, refren, ritëm,) tiparet romantike të treguara përmes subjektivitetit	• Numëron dhe përshkruan karakteristikat themelore të romantizmit dhe i lidh ato me kohën dhe kushtet shoqërore të shfaqjes së tij. • Krahason ngjashmëritë dhe ndryshimet midis romantizmit dhe klasicizmit, duke shpjeguar ndryshimet në marrëdhënien ndaj njeriut, natyrës dhe artit. • Numëron përfaqësuesit më domethënës të romantizmit në Europë dhe në Ballkan, duke i lidhur ata me idetë dhe veprat e tyre. • Identifikon dhe analizon temat dhe motivet romantike në tekste të ndryshme letrare. • Klasifikon dhe interpreton motivet dhe konceptet ideologjike në veprat e romantizmit në përputhje me vetë drejtimin e romantizmit. • Njeh dhe analizon tiparet stilistike (simbolizmin, subjektivitetin, emocionalitetin, ikjen tek idealja, kultin e individualitetit) në tekstet romantike. • Shpjegon mënyrat se si artisti shpreh unin lirik dhe qëndrimin subjektiv ndaj realitetit në një vepër të caktuar. • Analizon rolin e letërsisë popullore dhe mitologjisë në krijimtarinë romantike.

lirik; dramë fantastike; motivet: ndjenjat dhe pasionet personale, ndjenja e trishtimit, malli, dhimbja, pesimizmi - shfaqja e të ashtuquajturës dhimbje botërore (Weltschmerz), natyra, kulti i së kaluarës, populli, interesi për folklorin, vetëdija kombëtare, dashuria ndaj atdheut, irracionalizmi dhe misticizmi, malli për të paarrtshmen; idealizimi i jetës në fshat, kulti i natyrës, ideali i gruas dhe dashuria e njëanëshme); Romantizmi në Angli, Gjermani, Francë, Rusi dhe përfaqësuesit kryesorë Romantizmi në Angli (Uiliam Uordsuorth, Semjuel Tejlloor Koleri, Xhorxh Gordon Bajron, Persi Bish Shelli, Uallter Skot) Romantizmi në Gjermani (Johan Wolfgang von Gëte, Fridrih Shiler, Hajnrih Haine, Fridrih Hellderlin, Vëllezërit Grim, Ernest Theodor Amadeus Hofman) Romantizmi në Francë (Viktor Hygo, Fransua Rene dë Shatobrian, , Madam dë Stal, Alfons dë Lamartin, Alfred dë Myse, Alfred dë Vinji) Romantizmi në Rusi (Aleksandër Sergejeviç Pushkini, Mihaill Jurieviç Lermontov) Romantizmi në SHBA (Edgar Allan Poe) Romantizmi midis popujve të Ballkanit (përmbledhje)	• Interpretet idetë romantike dhe i krahason ato me temat bashkëkohore shoqërore dhe kulturore. • Harton një rezymë me gojë ose me shkrim të tipareve stilistike dhe ideologjike të romantizmit dhe jep shembuj. • Paraqet përfundimet e veta dhe vëzhgimet krahasuese mbi motivet e romantizmit në kontekste të ndryshme kulturore. <i>Vepra për analizë/përzgjedhje/fragmente:</i> - <i>“Udhëtimet e Çajld Haroldit”</i> nga Xh. G. Bajron – (analizë e dy poezive të para) - <i>“Vuajtjet e Verterit të ri”</i> nga Gëte - Përzgjedhje tregimesh të shkurtra nga E.T. A. Hofman - <i>“Njeriu që shiti hijen: historia e çuditshme e Peter Schlemihlit”</i> nga Adelbert von Shamiso. - <i>“Katedralja e Parisit”</i> dhe <i>“Të Mjerët”</i> nga Viktor Hygo - <i>“Eugjen Onjegini”</i> nga Pushkini - Përzgjedhje poezish nga Lermontovi - Poezi: <i>“Korbi”</i> dhe <i>“Tregime groteske dhe arabeske”</i>; Tregime të shkurtra të zgjedhura: <i>“Maska e vdekjes së kuqe”</i>, <i>“Macja e zezë”</i> dhe <i>“Letra e vjedhur”</i> nga Edgar Allan Poe - Përzgjedhje poezish nga France Preshen, Petar II Petroviq Njegosh, Gjura Jakshiq, Georgi Rakovski - <i>“Mall për jugun”</i> nga Konstantin Milladinovi - <i>“Intibah”</i> (Zgjimi) nga Namik Kemal - <i>“30 poetë grekë”</i> – antologji e poezisë greke - <i>“Ëndrra dhe e vërteta”</i> nga Fatma Alije
---	---

(Vuk Stefanoviq Karaxhiq, Gjura Jakshiq, Branko Radiçeviq, Llaza Kostiq, Jovan Jovanoviq Zmaj, France Preshern, Petar II Petrovqi Njegosh, Georgi Rakovski) Romantizmi në letërsinë maqedone (Konstantin Milladinov) Romantizmi në letërsinë turke (Namik Kemal)	
Romantizmi dhe Rilindja Kombëtare shqiptare Mbledhësit e folklorit shqiptar Letërsia shqiptare e Romantizmit dhe e Rilindjes Kombëtare	• Përshkruan karakteristikat themelore të romantizmit dhe të Rilindjes Kombëtare shqiptare dhe kushtet shoqërore-politike të kohës, në të cilën u paraqit. • Përshkruan jetën dhe veprimtarinë e mbledhësve të krijimtarisë popullore dhe shpjegon rolin e tyre në forcimin e vetëdijes kombëtare. • Përmend mbledhësit më të rëndësishëm të krijimtarisë popullore shqiptare dhe i lidh me veprat dhe përmbledhjet e tyre më të njohura si: Thimi Mitko me <i>“Bleta shqiptare”</i> dhe Zef Jubani me <i>“Përmbledhje këngësh popullore dhe rrapsodish shqiptare”</i>. • Analizon veprat <i>“Serafina Topia”</i> dhe <i>“Këngët e Milosaos”</i> nga Jeronim de Rada dhe identifikon elementet historike dhe ato letrare. • Shpjegon kontributin e Gavril Darës dhe dallon vlerat artistike të poemës <i>“Kënga e Sprapsme e Balës”</i>, personazhet, elementet folklorike dhe gjuhën artistike. • Përshkruan temat dhe motivet në poezitë <i>“Vrull”</i>, <i>“Për lirinë e Venetisë”</i> dhe <i>“Elegji”</i> të Zef Serembes. • Analizon veprën <i>“Emira”</i> nga Anton Santori dhe tregon rëndësinë e saj si dramë e parë në letërsinë shqipe. • Identifikon dhe shpjegon kontributin e Naim Frashërit dhe përshkruan tiparet romantike në veprat <i>“Lulet e verës”</i> dhe <i>“Bagëti e bujqësi”</i> si dashuria për atdheun, për përkatësinë kombëtare dhe për gjuhën shqipe. • Shpjegon kontributin e Sami Frashërit si veprimtar i Rilindjes Kombëtare dhe shpjegon karakterin dhe strukturën e veprës <i>“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”</i>. • Përshkruan jetën shqiptare të kohës në romanin <i>“Bardha e Temalit”</i> dhe në veprën <i>“O moj Shqypni”</i> nga Pashko Vasa dhe analizon personazhet dhe idetë filozofike e shoqërore në to.

- Dallon motivin e mallit dhe të dhembjes personale në poemën *“Vaji i bylbylit”*; njeh jetën autentike të botës shqiptare dhe shpjegon strukturën e poemës *“Andrra e jetës”* nga Ndre Mjeda.
- Identifikon larmitë tematike dhe veçoritë artistike në përmbledhjen *“Baba Tomorri”* dhe kupton artin poetik dhe humoristik në komedinë *“14 vjeç dhëndër”* të Andon Zako Çajupi.
- Dallon tematikat e ndryshme në veprat *“Rreze dielli”*, *“Ëndërra dhe lotë”*, *“Psallme murgu”*, *“Këmbanat e Krujës”* nga Aleks S. Drenova – Asdreni.
- Shpjegon kontributin e Asdrenit dhe analizon poezinë *“Hymni i flamurit”* duke shpjeguar rëndësinë e saj për zhvillimin e ndjenjës së atdhedashurisë deri në ditët e sotme.
- Shpjegon rolin e Zef Skiroit në letërsinë arbëreshe dhe analizon tematikën dhe vlerat artistike të veprës *“Te dheu i huaj”*.
- Njeh rëndësinë e aktivitetit letrar të Ndoc Nikajt, autorit të romanit të parë të shkruar në gjuhën shqipe dhe përshkruan përmbajtjen e veprës *“Bukurusha”*.
- Krijon një tekst të shkurtër (ese, shënim poetik ose poster) në të cilin përmes frymës romantike shpreh dashurinë për atdheun dhe për gjuhën.

Vepra për analizë:

- *“Serafina Topia”* dhe *“Këngët e Milosaos”* nga Jeronim de Rada
- *“Kënga e Sprasme e Balës”* nga Gavril Dara
- *“Vrull”*, *“Për lirinë e Venetisë”*, *“Elegji”* nga Zef Serembe
- *“Emira”* nga Anton Santori
- *“Historia e Skënderbeut”*, *“Lulet e verës”* dhe *“Bagëti e bujqësi”* nga Naim Frashëri
- *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”* nga Sami Frashëri
- *“O moj Shqypni”* dhe *“Bardha e Temalit”* nga Pashko Vasa
- *“Juvenilja”* (poemat: *“Andrra e jetës”*, *“Vaji i bylbylit”*) nga Ndre Mjeda
- *“Baba Tomorri”* dhe *“14 vjec dhëndër”* nga Andon Zako Çajupi
- *“Lulekuqja”*, *“Rreze dielli”*, *“Ëndërra dhe lotë”*, *“Psallme murgu”*, *“Këmbanat e Krujës”* nga Aleks S. Drenova – Asdreni
- *“Te dheu i huaj”* nga Zef Skiroi
- *“Bukurusha”* nga Ndoc Nikaj

TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA	
Ese – llojet e eseve Shënime biobibliografike CV (Curriculum Vitae) Raport Procesverbal Plotësimi i formularëve Të shkruarit krijues i teksteve letraro-artistike (tregim i shkurtër, skicë)	• Klasifikon esenë sipas përmbajtjes, stilit dhe qëllimit (artistike, shkencore, kritike, personale). • Formulon një tezë të qartë në pjesën hyrëse të esesë dhe e mbështet atë me argumente, shembuj dhe shpjegime. • Strukturon një paragraf me fjali kryesore, me zhvillim, me shembull dhe me mendim përmbyllës. • Lidh idetë në ese në mënyrë logjike dhe të kuptueshme, duke përdorur koherencë të përshtatshme ndërmjet paragrafëve. • Dallon përmbajtjen, strukturën dhe stilin e biografisë dhe të shënimit biobibliografik. • Përshtat stilin dhe gjuhën në kontekst formal gjatë shkrimit të një shënimi biobibliografik. • Shkruan CV-në personale me të dhëna të qarta për informacionet personale, arsimin, përvojën dhe interesat. • Dallon raportin nga procesverbali sipas qëllimit, strukturës dhe stilit. • Shkruan raport për një ngjarje ose projekt të realizuar, duke përdorur fraza të thjeshta dhe të sakta. • Harton procesverbal nga një mbledhje ose takim, duke përfshirë të dhëna për vendin, kohën, pjesëmarrësit dhe përfundimet. • Plotëson lloje të ndryshme formularësh me të dhëna të sakta dhe të plota. • Shkruan tekst në prozë me kompozim të qartë: hyrje, pjesë kryesore (ngjarje, përshkrim) dhe pjesë përmbyllëse. • Krijon tregim të shkurtër duke përdorur teknika krijuese (dialog, përshkrim, kthesë befasuese, perspektivë). • Krijon strip duke ndjekur hapat e procesit: ideja, dialogët dhe kompozicioni vizual. • Krijon me vetëdije lidhur me raportin ndërmjet tekstit dhe vizatimit në strip për të arritur shprehshmëri dhe efekt.
Shembuj veprimtarish: Veprimtari individuale • Çdo nxënës krijon një “tweet në stilin e klasicizmit” ose një mini-ese (deri në 100 fjalë) mbi një temë bashkëkohore (teknologjia, miqësia, ekologjia), duke përdorur tipare stilistike dhe vlera të klasicizmit.	

- Nxënësit shkruajnë një odë ose një himn në frymën e klasicizmit, kushtuar një teme bashkëkohore (p.sh. *Oda e dijes, Himni i paqes*), duke theksuar vlerat estetike dhe morale.
- Nxënësit shkruajnë një shënim redaksional për një revistë imagjinare, në të cilin shpjegojnë pse klasicizmi është i rëndësishëm edhe sot.

Veprimtari hulumtuese

- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, hulumtojnë temën: “Kontributi i grave shqiptare në shekullin XIX”. Rezultatet i paraqesin përmes një prezantimi PowerPoint ose një eseje të shkurtër. Në fund shkëmbejnë informacionet dhe diskutojnë për rëndësinë e informacionit të gjetur. (Si burim mund të përdoret vepra e Hanëmshahe Ilazit “*Gra të njohura të trojeve shqiptare*”).
- Nxënësit hulumtojnë mbi temën: *Pse romantizmi shqiptar quhet Rilindje?* dhe përgatisin një tekst të shkurtër (ese, fjalim ose kolazh digjital). Në fund, përmbledhin përfundimet në një tabelë ose në një paraqitje grafike.

Diskutim

- Nxënësit diskutojnë për ngjajshmëritë dhe dallimet në trajtimin e temave të Romantizmit në letërsinë e ndryshme kombëtare. Rezultatet i paraqesin përmes një diagrami të Vennit, duke krahasuar romantizmin shqiptar me romantizmin evropian. (Si burim mund të përdoren “*Antologjia e mendimit shqiptar*” nga Ndriçim Kulla, “*Antologjia e lirikës shqipe: prej De Radës e këndej*” nga Rexhep Qosja etj.).

Kuize dhe vlerësim i njohurive

- Mësimdhënësi/ja përgatit një kuiz online përmes aplikacioneve (Kahoot, Quizizz, Blooket) me pyetje për mbledhësit e folklorit shqiptar dhe veprimtarinë e tyre (Thimi Mitko, Zef Jubani etj.).
 - Nxënësit i zgjidhin pyetjet në mënyrë të pavarur, kurse rezultati bazohet në saktësinë dhe shpejtësinë e përgjigjeve.
 - Pas kuizit, zhvillohet një reflektim i shkurtër: çdo nxënës shkruan çfarë ka mësuar dhe çfarë e ka befasuar.

Veprimtari krijuese

- Nxënësit shkruajnë një mini-skenë të imagjinuar (dialog prej 10–15 fjalish) në të cilën takohen një personazh nga klasicizmi dhe një personazh nga romantizmi, duke debatuar mbi temën: “*Arsyeja apo ndjenja?*”
- Çdo nxënës krijon një poster digjital të frymëzuar nga Rilindja Kombëtare Shqiptare (Naim Frashëri, Pashko Vasa, A.Z. Çajupi), me një citat ose shënim të shkurtër që shpjegon idenë e Rilindjes.

- Nxënësit përgatisin një “kartëvizitë letrare” për një autor klasik (Rasin, Molier, Boalo etj.), që përmban idetë kryesore, një simbol, një citat dhe një mendim estetik të shkurtër.

Fusha programore: NJOHURI MEDIATIKE

Gjithsej: 14 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të njohë dhe të përshkruajë format e ndryshme mediatike (tekst, audio, video, infografik) dhe karakteristikat e tyre specifike;
2. të shpjegojë se si mediat dhe gjuha që ato përdorin ndikojnë në formimin e mendimit dhe perceptimit të publikut;
3. të identifikojë dhe të analizojë shembuj të gjuhës së urrejtjes, stereotipeve dhe paragjykimeve në përmbajtje të ndryshme mediatike;
4. të zbatojë parimet bazë etike dhe ligjore gjatë përdorimit dhe krijimit të përmbajtjeve mediatike;
5. të krijojë prodhime origjinale mediatike (tekst, podcast, video ose mesazh vizual) që përcjellin një qëndrim personal, një ide ose një mesazh shoqëror;
6. të shpjegojë ndikimin dhe rolin e përmbajtjeve mediatike në shoqërinë bashkëkohore dhe në komunikimin e përditshëm.

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

1. mediat kanë ndikim të fuqishëm në formimin e opinionit publik, qëndrimeve dhe sjelljes së individëve dhe të komunitetit;
2. përdorimi i përgjegjshëm dhe kritik i përmbajtjeve mediatike kontribuon në informim të drejtë për sjellje qytetare, tolerante dhe aktive;
3. parimet etike dhe respektimi i të drejtave të autorit janë të domosdoshme për komunikim korrekt dhe të sigurt në hapësirën digjitale;
4. të shprehurit krijues përmes mediave është një mjet për zhvillim personal, përfshirje shoqërore dhe ndikim pozitiv në shoqëri.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)	Standardet e vlerësimit:
Të kuptuarit e formateve mediatike (medium, format, tekst, blog, podcast, video, audio përmbajtje, infografik, platformë, stil, gjuhë vizuale, prodhim (produksion), multimedialitet)	• Njeh dhe emërton formatet e ndryshme mediatike (tekst, blog, podcast, video, audio përmbajtje, infografik). • Përshkruan karakteristikat themelore dhe mënyrën e komunikimit për secilin format mediatik. • Krahason formatet mediatike sipas formës, qëllimit dhe audiencës. • Shpjegon se si zgjedhja e formatit mediatik ndikon në mënyrën e përcjelljes dhe të kuptuarit të mesazhit.

	Identifikon elementet e multimedialitetit (imazh, tingull, tekst, grafikë) në shembuj konkretë mediatikë.
Gjuha dhe mediat (mesazhi mediatik, perceptimi, manipulimi, stereotipi, gjuha e urrejtjes, gjuha mediatike, gjykimi vlerësues, ndikimi, etika) Stereotipet në media dhe ndikimi i tyre mbi publikun (gjuha, media, stereotipi, perceptimi, mesazhi mediatik, gjuha e urrejtjes, paragjykimet, diskriminimi, etika mediatike, përgjegjësia ligjore, të lexuarit kritik)	- Njeh mesazhet mediatike dhe jep shembuj se si ata mund të ndikojnë në qëndrimet dhe mendimin e publikut. - Dallon ngjarjet me vlerë mediatike nga informacionet e rëndomta, sipas kritereve, si: interesi publik, vlera gazetareske dhe aktualiteti i ngjarjes. - Identifikon dhe përshkruan shembuj të gjuhës së urrejtjes, paragjykimeve dhe stereotipeve në formate të ndryshme mediatike (tekste online, komente, video, rrjete sociale). - Shpjegon se si përzgjedhja e fjalëve, toni dhe elementet vizuale ndikojnë në krijimin e perceptimit të publiku. - Shpjegon se si stereotipet mund të riprodhohen dhe të përforcohen përmes përmbajtjeve të ndryshme mediatike. - Analizon shembuj mediatikë në të cilët janë të pranishme paragjykimet, mesazhet diskriminuese ose gjuha e urrejtjes. - Identifikon dhe propozon strategji për njohjen, për parandalimin dhe për reagimin ndaj gjuhës së urrejtjes dhe ndaj stereotipeve në media. - Njeh dhe shpjegon situatat në të cilat janë shkelur normat etike ose të drejtat e individëve në komunikimin mediatik.
Të krijuarit e përmbajtjeve origjinale	- Planifikon përmbajtje mediatike (ese, podcast, video ose poster) me temë dhe qëllim të qartë. - Krijon një përmbajtje origjinale që shpreh një ide ose një mesazh personal. - Përdor gjuhë të qartë, imazhe ose tinguj në përputhje me formatin e zgjedhur. - Zbaton rregullat bazë për të drejtat e autorit dhe për përdorimin etik të përmbajtjeve mediatike. - Shpjegon se si përmbajtja e tij/saj mund të ndikojë ose të dërgojë një mesazh te publiku.
Shembuj veprimtarish: Analizë e një mesazhi mediatik Nxënësit zgjedhin një lajm, postim ose klip reklamues dhe e analizojnë atë sipas mesazhit, tonit dhe vlerave që përcjell. Krahasim i mediave	

- Nxënësit në grupe, zgjedhin dy formate të ndryshme mediatike (p.sh. një lajm në portal dhe një kronikë në video) për të njëjtën ngjarje dhe i krahasojnë këto formate në aspektin e gjuhës, stilit vizual dhe ndikimit mbi publikun.

Vlerësim i besueshmërisë

- Nxënësit hulumtojnë burime të ndryshme online për një temë aktuale dhe i vlerësojnë sipas kriterëve: burimi i informacionit, autori, gjuha, toni emocional dhe saktësia faktike.

Simulim dhe luajtja në role

- **Redaksi gazetareske** - nxënësit marrin rolet e redaktorëve, gazetarëve dhe dizajnerëve. Së bashku krijojnë një përmbajtje të shkurtër mediatike (lajm, infografik, podcast), duke theksuar etikën mediatike dhe verifikimin e fakteve.
- **Debati “Fuqia e mediave”** - grupe nxënësish mbrojnë qëndrime të ndryshme (p.sh.: *“Mediet janë pasqyra e shoqërisë”* kundrejt *“Mediet e formësojnë shoqërinë”*) dhe i mbrojnë ato me argumente.

Diskutim

- Mësimdhënësi/ja shtron pyetje për të udhëhequr bisedën, për shembull:
 - Si ndikon mënyra e të shprehurit në media në mënyrën se si e kuptojmë ngjarjen?
 - A janë të gjitha informacionet në media njësoj të besueshme? Pse?
 - Cilat fjalë ose imazhe mund të krijojnë paragjykime te publiku?

Nxënësit i arsyetojnë qëndrimet e tyre dhe i mbështesin me shembuj nga mediet. Në fund, së bashku me mësimdhënësin/en, formulojnë përfundim të përbashkët – për shembull: *“Gjuha në media mund të formësojë mendimet, prandaj është e rëndësishme të lexojmë çdo mesazh në mënyrë kritike.”*

Veprimtari krijuese

- **Krijimi i një mesazhi mediatik** - nxënësit krijojnë një ese të shkurtër, video, podcast ose postim digjital me një mesazh pozitiv shoqëror (tolerancë, empati, mendim kritik).
- **Ridizajnimi i një mesazhi mediatik** – nxënësit zgjedhin një postim ose reklamë që përmban elemente stereotipike dhe e ripërpunojnë në mënyrë etike dhe gjithëpërfshirëse (inkluzive).
- **Krijimi i një infografiku** - nxënësit përgatisin një paraqitje vizuale me këshilla për përdorim të sigurt, etik dhe kritik të mediave.

Kuize dhe vlerësim i njohurive

- **“Njih median”** - nxënësit marrin fragmente nga formate të ndryshme mediatike (lajm, blog, post reklamues, transkript i podcast-it) dhe kanë për detyrë të identifikojnë formatin mediatik dhe karakteristikat e tij.
- **“Gjuha dhe stereotipet në media”** - nxënësit marrin shembuj nga tekste, reklama ose postime në rrjete sociale dhe duhet të zbulojnë cilat fjalë, shprehje ose imazhe përcjellin stereotipe. Pastaj shpjegojnë shkurt se si ato ndikojnë në perceptimin e publikut.
- **“Etike apo joetike?”** – Mësimdhënësi/ja tregon situata të shkurtra mediatike (postim, titull, koment), dhe nxënësit vendosin nëse komunikimi është etik ose joetik, duke shpjeguar arsyet me referencë të një parim ose rregull etike.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE DHE INTEGRIMI NDËRKULTUROR

Mësimdhënësit/et në arsimin e gjimnazit nxisin gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirje aktive të të gjithë nxënësve në aktivitetet mësimore. Ata përshtasin në mënyrë adekuate metodat e punës për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme njohëse dhe emocionale të nxënësve, duke përdorur qasje të tilla si individualizimi, diferencimi, punë në grupe dhe mbështetje nga shokët/shoqet e klasës. Gjatë punës me nxënësit me aftësi të kufizuara, mësimdhënësit zbatojnë plane arsimore individuale që përfshijnë rezultate të të nxënës dhe standarde vlerësimi të personalizuar dhe ofrojnë mbështetje shtesë nga asistentët arsimorë, ndërmjetësit, tutorët vullnetarë dhe profesionistët nga qendra të ndryshme burimore.

Ndjekja e rregullt e përparimit të nxënësve, veçanërisht të grupeve të ndjeshme (vulnerabël) është thelbësore. Mësimdhënësit/et identifikojnë vështirësitë e mundshme në kohën e duhur dhe ofrojnë udhëzime për tejkalimin e tyre, duke dhënë mbështetje të duhur për arritjen e rezultateve të të nxënës. Kjo qasje jo vetëm që inkurajon arritjet akademike, por gjithashtu ndërton vetëbesimin e nxënësve dhe ndjenjën e tyre të përkatësisë.

Në promovimin e barazisë gjinore, mësimdhënësit/et duhet të jenë të kujdesshëm që të mos nxisin role stereotipike gjinore gjatë organizimit të aktiviteteve. Gjatë formimit të grupeve të punës ose caktimit të detyrave, mësimdhënësit/et sigurojnë ekuilibër midis djemve dhe vajzave, ndërsa duke përdorur shembuj, tekste dhe ilustrime, ata mbështesin ndjeshmërinë gjinore dhe inkurajojnë nxënësit të kapërcejnë stereotipet gjinore. Procesi mësimor planifikohet në mënyrë që barazia gjinore dhe ndjeshmëria etnike/kulturore të jenë pjesë e natyrshme e të gjitha aktiviteteve, veçanërisht përmes përdorimit, kudo që është e mundur, të materialeve dhe përmbajtjeve që promovojnë ndërkulturalizmin dhe integrimin ndëretnik.

Mësimdhënësit/et i njohin nxënësit me perspektiva të ndryshme kulturore përmes aktiviteteve që promovojnë respektimin e diversitetit në të gjitha situatat e mundshme. Kjo u mundëson nxënësve të zhvillojnë ndërgjegjësim për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor, që është baza për krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie kohezive dhe në harmoni.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi/ja ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione kthyes të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi i përcjell nxënësit dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e parashtruara nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- veprimtaritë hulumtuese përmes të cilave nxënësi heton: për karakteristikat e gjuhës, për përdorimin e gjuhës standarde të folur dhe të shkruar në lloje të ndryshme komunikimi, për përdorimin e drejtshkrimit në të shprehurit me shkrim në lloje të ndryshme tekstesh e kontekstesh dhe periudha e epoka të caktuara, duke lidhur prirjet shoqërore dhe prirjet e tjera zhvillimore me veprën/autorin;
- prezantimet për tema të ndryshme që lidhen me të tri fushat programore;
- prezantimet për analizë dhe interpretim të teksteve letrare dhe joletrare përmes citimeve, argumenteve dhe shembujve;
- punimet e ndryshme me fjalime, me ese, me forma letrare poetike dhe me prozë;
- raportet e shkruara që paraqesin të dhëna dhe informacione në formate e në forma të ndryshme duke përdorur paraqitje objektive nga burimet përkatëse;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet e kuizeve (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;
- pjesëmarrjen dhe angazhimin në aktivitete, diskutime dhe punë ekipore.

Nxënësi merr notë sumative (përmbledhëse) për standardet e arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me vlerësimin e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Gjatë vitit shkollor dhe në fund të vitit nxënësi merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2026/2027
Institucioni/bartësi i programit mësimor	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Sipas nenit 21 paragrafi 3 i ligjit për arsimin e mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17, 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.229/20, 78/25 dhe 132/25), Ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin II</i> (e dytë) të arsimit të gjimnazit. Согласно член 21 став 3 од Законот за средното образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 и 67/17, 64/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 229/20, 78/25 и 132/25), министерката за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик и литература</i> за II (втора) година гимназиско образование.	Бр./nr. <u>13-15232/3</u> data <u>04.12.2025</u> година Министерка за образование и наука/ Ministre e Arsimit dhe Shkencës, проф. д-р Весна Јаневска, с.р.